

20110511390

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR ORGANIZIMIN DHE PUNEN E ORGANEVE
TË ADMINISTRATES SHTETERORE

Neni 1

Në Ligjin për organizimin dhe punen e organeve të administrates shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 58/2000, 44/2002, 82/2008 dhe 167/10), në nenin 12 paragrafi (1) alineja 4 shlyhet.

Neni 2

Neni 33 shlyhet.

Neni 3

Të punësuarit në Agjenci për Zhvillim dhe Investime, që i kryejnë punët që kanë të bëjnë me arketimin e kërkesave dhe përmbushjen e detyrimeve në pjesën e portofolit kreditor, merren në Ministrinë e Financave, ndërsa të punësuarit që i kryejnë punët që kanë të bëjnë me realizimin e aktiviteteve zhvillimore dhe investuese merren në Ministrinë e Ekonomisë. Të punësuarit tjerë që nuk do të merren në Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Ekonomisë, merren në Agjencinë për Menaxhim me Pronën e Konfiskuar.

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji Ministria e Financave i merr lokalet në të cilat është vendosur Agjencia për Zhvillim dhe Investime.

Pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera për punë të Agjencisë për Zhvillim dhe Investime që lidhen me kryerjen e punëve të të punësuarve nga paragrafi (1) i këtij neni që merren në Ministrinë e Financave, merren në Ministrinë e Financave. Kërkesat dhe përmbushjet e detyrimeve në pjesën e portofolit kreditor të Agjencisë për Zhvillim dhe Investime i merr Ministria e Financave.

Pajisja, dokumentacioni dhe mjetet tjera për punë të Agjencisë për Zhvillim dhe Investime që lidhen me kryerjen e punëve të të punësuarve nga paragrafi (1) i këtij neni që merren në Ministrinë e Ekonomisë, merren në Ministrinë e Ekonomisë.

Neni 4

Me ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për plotësimin e Ligjit për barna dhe vegla ndihmëse mjekësore ("Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" numer 36/11) shfuqizohen dispozitat e nenëve 22 paragrafi 2 dhe 65 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administrates shtetërore, që kanë të bëjnë për Byronë e Barnave.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".